



Mos humbisni rastin për zbritjen e banimit primar!

2021-11-19

Kanë mbetur më pak se dy javë që të regjistroheni, për të përfituar zbritjen e banimit primar.

Për të përfituar këtë zbritje për vitin 2022 dhe tutje, ju duhet të regjistroheni më së voni deri më **30 Nëntor, 2021**.

Pronën tuaj mund ta regjistroni vetëm me numër personal. Duhet të sillni letërnjohimin me vete në zyrën komunale të tatimit në pronë për t'u regjistruar. Përdorni formën për vet-deklarim për të regjistruar pronën tuaj.

Zbritja për banim primar është 15.000 € nga vlera e vlerësuar. Në normë tatimore prej 0.15% kjo nënkupton 22.50 € më pak tatim secilin vit.

Ju mund të keni vetëm një banim primar – pra sigurohuni që të mos keni regjistruar më shumë se një pronë, pasi që kjo mund të shpie në [gjobë](#).